



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 06/2023 PËR MASAT E DUHURA
PARANDALUESE DHE MBROJTËSE PËR NDALIMIN E PJESËMARRJES SË
FËMIJËVE NË KLUBET E NATËS DHE HAPËSIRA TË TJERA TË NGJASHME¹**

¹ Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 06/2023 për Masat e duhura Parandaluese dhe Mbrojtëse për Ndalimin e Pjesëmarrjes së Fëmijëve në Klubet e Natës dhe Hapësira të tjera të ngjashme është miratuar në Mbledhjen e 154-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 04/154, të datës 09.08.2023.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 8, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 44, paragrafit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 14 / 17 korrik 2019), si dhe nenin 19, paragrafin 6.2 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, Nr.15, 12.09.2011),

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 06/2023 PËR MASAT E DUHURA PARANDALUESE DHE MBROJTËSE PËR NDALIMIN E PJESËMARRJES SË FËMIJËVE NË KLUBET E NATËS DHE HAPËSIRA TË TJERA TË NGJASHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është mbrojtja e shëndetit fizik dhe mendor, sigurisë dhe mirëqenies së fëmijëve nëpërmjet ndalimit të pjesëmarrjes së tyre në klubet e natës, ambientet e destinuar për konsum të alkoolit, qendrat e argëtimit për të rritur dhe forma tjera të ndaluara në të cilat i ekspozohen situatave dhe substancave të papërshtatshme, të ndaluara për moshën e tyre.
2. Ky udhëzim administrativ gjithashtu përcakton masat dhe veprimet që kërkohen të ndërmerren nga autoritetet përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal, si dhe përgjegjësinë e bizneseve, prindërve dhe/apo kujdestarëve lidhur me mbrojtjen e fëmijës nga format të cilat rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e fëmijës.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga të gjitha institucionet relevante, bizneset që janë të regjistruara si klube të natës, qendrat e argëtimit për të rritur dhe format tjera për të cilat vlen ndalesa e pjesëmarrjes së fëmijës.
2. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet edhe nga prindërit, kujdestarët, profesionistët e mbrojtjes së fëmijës, konform mandatit, obligimeve dhe përgjegjësisë që janë të parapara në Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.
3. Ky Udhëzim Administrativ nuk vlen për lojërat e fatit të cilat janë të ndaluara sipas Ligjit Nr.06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ, kanë këtë kuptim:

1.1. **shërbimet për mbrojtjen e fëmijës** – nënkupton të gjitha shërbimet qëllimi i të cilave është që fëmijës t'i ofrohet mbrojtja sipas parimeve të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.2. **klub i natës** - nënkupton vendet dhe lokalet të cilat hapen dhe operojnë veçanërisht gjatë orëve të natës, konsumohet alkooli, duhani dhe substanca tjera të ndaluara për fëmijë dhe/apo, kanë muzikë të lartë dhe ndriçim të reduktuar;

1.3. **qendrat e argëtimit për të rritur** – nënkuptojnë hapësira të destinuara për socializim dhe rekreacion në të cilat konsumohet alkooli, duhani e substanca të ngjashme të ndaluara për fëmijë duke mos u kufizuar në baret e ndryshme, organizimin e ngjarjeve për të rritur, organizimeve në natyrë në bazë të karakterit të të cilave vlerësohet se pjesëmarrja e fëmijëve mund të rezultojë në dëm fizik dhe mendor, si dhe mund t'i rrezikohet siguria e tij, të tilla si festivalet, koncertet, etj.;

1.4. **format tjera të ndaluara** - nënkuptojnë hapësirat e ndaluara me legjislacionin në fuqi dhe ato që sipas natyrës së tyre nuk janë të përshtatshme për prezencë të fëmijëve;

1.5. **MPB** – nënkupton Ministrinë e Punëve të Brendshme;

1.6. **MINT** – nënkupton Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;

1.7. **PSO** – nënkupton Procedurë Standarde Operimi.

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ, kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.

Neni 4 Parimet udhëheqëse

Në të gjitha veprimet dhe masat e parapara në këtë Udhëzim Administrativ, institucionet dhe akterët relevant udhëhiqen, dhe duhet të kenë parasysh dhe të zbatojnë me prioritet parimet bazë të përcaktuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, për të siguruar që jeta, dinjiteti dhe integriteti i fëmijës është i garantuar dhe mbrojtur në çdo moment.

Neni 5 Parandalimi

1. Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet nëpërmjet të cilave parandalohen veprimet që rrezikojnë mirëqenien dhe interesin e fëmijës përfshirë pjesëmarrjen në hapësirat apo ambientet e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

2. Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin masat e nevojshme profesionale dhe ligjore nëpërmjet të cilave promovojnë të drejtat e fëmijës, ngritjen e vetëdijes dhe edukimit

të fëmijëve, prindërve dhe shoqërisë në përgjithësi, nxjerrjen e politikave pro aktive dhe masave për adresimin e nevojave të grupeve të cenuara dhe diskriminuara, prindërve dhe mbështetjen e familjeve.

Neni 6 **Reagimi dhe ndalimi**

1. Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse duhet të reagojnë për të ndaluar pjesëmarrjen e fëmijës në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe format e tjera të ndaluara.
2. Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse, duhet që në mënyrë aktive të realizojnë kontrollimin e hapësirave të klubeve të natës me qëllim që të sigurojnë që fëmijët të mos jenë të pranishëm.

Neni 7 **Trajtimi dhe ndihma**

1. Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe këtij Udhëzimi Administrativ, duhet të ndërmarrin veprime për trajtimin e fëmijës që frekuenton klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur apo format tjera të ndaluara, duke përfshirë, por mos u kufizuar në:

1.1. dëmshpërblim në kuptimin juridik;

1.2. mbështetjen financiare dhe profesionale;

1.3. këshillimin dhe trajtimin afatgjatë konform dëmit të shkaktuar dhe ndikimit në jetën e fëmijës.

2. Mekanizmat e raportimit dhe ankimimit, përfshirë edhe linjën e ndihmës së drejtpërdrejtë, duhet të jenë të integruara në sistemin që synon mbrojtjen e fëmijës.

Neni 8 **Proporcionaliteti i kufizimeve dhe ndalimeve**

1. Proporcionaliteti i kufizimeve dhe ndalimeve kërkon që qëllimi i kufizimit të arrihet me masat më së paku kufizuese, duke ruajtur dhe balancuar interesat dhe të drejtat e fëmijës.
2. Në rastet kur ka dyshim të bazuar apo kur është identifikuar rreziku që i kanoset fëmijës, të gjithë bartësit e përgjegjësive janë të detyruar të ndërmarrin masa për ndalimin e çfarëdo pjesëmarrje të fëmijës në klube të natës dhe aktivitetet e tjera të ndaluara sipas këtij Udhëzimi Administrativ.
3. Kufizimi dhe ndalimi sipas paragrafëve 1 dhe 2 duhet të përfundoj në momentin kur vlerësohet se rreziku pushon së ekzistuari dhe që fëmija ka arritur nivelin e duhur të vetëdijesimit mbi ato rreziqe.

Neni 9

Ndalimi i pjesëmarrjes së fëmijës në klubet e natës

1. Klubet e natës obligohen të ndalojnë hyrjen e fëmijës në të gjitha ambientet e klubit, qofshin ato brenda apo jashtë.
2. Klubet e natës obligohen të ndërmarrin masa të kontrollimit të moshës së pjesëmarrësve, me qëllim ndalimin e hyrjes së fëmijës në ambientet e klubit të natës.
3. Në rast se fëmija për arsye të ndryshme ka hyrë dhe është prezent në klub të natës, atëherë personi përgjegjës i klubit të natës duhet menjëherë të njoftojë Policinë dhe/apo Qendrën për Punë Sociale.
4. Nëse gjatë pjesëmarrjes nga të rriturit apo kontrollit dhe inspektimit nga institucionet, identifikohet apo zbulohet që një fëmijë është i pranishëm në klub të natës, duhet njoftohet të Policia dhe/apo Qendra për Punë Sociale menjëherë.
5. Klubet e natës duhet që në hyrje dhe pjesë të dukshme të objektit të vendosin shenja dalluese me të cilat shënjohe ndalesa e pjesëmarrjes së personave nën moshën 18 vjeçare.

Neni 10

Ndalimi i pjesëmarrjes së fëmijës në qendrat argëtuese për të rritur dhe hapësira të ngjashme

1. Nëse vlerësohet që pjesëmarrja e fëmijës në një qendër argëtuese apo hapësirë tjetër të ngjashme do të jetë e dëmshme për shëndetin fizik apo mendor, apo është kundër interesit më të mirë të fëmijës, personat përgjegjës pranë këtyre qendrave, por edhe prindërit dhe kujdestarët duhet të ndërmarrin veprime që parandalojnë dhe ndalojnë pjesëmarrjen e fëmijës, duke përfshirë por mos u kufizuar në ndalimin e pjesëmarrjes në vendet si në vijim:
 - 1.1. qendrat rekreative dhe sportive;
 - 1.2. qendrat për lojëra zbavitëse;
 - 1.3. kinema apo teatër;
 - 1.4. baret e ndryshme;
 - 1.5. organizimi i ngjarjeve për rritur;
 - 1.6. festivale apo koncerte.

2. Masat ndaluese sipas paragrafit 1. të këtij neni do të zbatohen konform një vlerësimi paraprak që bazohet në këto kriterë:

- 2.1. mosha e fëmijës;
- 2.2. shkalla e rrezikshmërisë;
- 2.3. lloji i shërbimit që ofrohet;
- 2.4. niveli i mundshëm i ndikimit;
- 2.5. formati i organizimit të ngjarjes.

Neni 11 Identifikimi

1. Përgjegjës për identifikimin e fëmijës i cili është prezent në klube të natës, në qendra të argëtimit për të rritur apo format tjera të ndaluara, janë:

- 1.1. pronarët, menaxherët apo personat përgjegjës të klubeve të natës, qendrat e argëtimit për të rritur apo format tjera të ndaluara;
- 1.2. inspektoratet në nivel qendror dhe lokal;
- 1.3. Policia e Kosovës;
- 1.4. shkollat;
- 1.5. autoritetet për mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror dhe lokal;
- 1.6. prindërit apo kujdestarët ligjor.

Neni 12 Obligimi për raportim

1. Çdo person fizik apo juridik që vëren, ka arsye për të dyshuar ose ka informacion për një situatë që fëmija është duke marrë pjesë në klube të natës, qendra argëtuese për të rritur ose forma tjera të ndaluara apo edhe në situata ku fëmijës është duke iu shitur alkool, apo ndonjë substancë e dëmshme për shëndetin e tij apo saj, është i obliguar që të raportojë rastin me shkrim ose gojarisht në Polici, në Qendrën përkatëse për Punë Sociale.

2. Qendra për Punë Sociale ka për detyrë të njoftoj Policinë në çdo rast të referimit të mbrojtjes së fëmijës dhe anashjelltas, Policia është e detyruar të njoftoj Qendrën për Punë Sociale në çdo rast të raportimit të rasteve të cekura më lart.

3. Mos raportimi i abuzimit të fëmijës përbën veprë penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ndiqet sipas legjislacionit relevant në fuqi.

Neni 13 Referimi

Autoritetet në nivel qendror dhe lokal, përfshirë prindërit dhe kujdestarët, rastet e identifikuara ose raportuara, duhet t'i referojnë tek shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, kur ata janë subjekte të përfshira në situatat e ndaluara sipas këtij Udhëzimi Administrativ dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Neni 14 Bashkëpunimi ndër-institucional

1. Autoritetet në nivel qendror dhe lokal, si dhe përgjegjësit e tjerë ndërmarrin hapat e duhur për të përmirësuar bashkëpunimin ndër-institucional me qëllim parandalimin, identifikimin, raportimin dhe referimin e rasteve pranë shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës, për veprimet që përfshijnë ndalimin e pjesëmarrjes në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur apo forma të tjera të ndaluara.

2. Pjesë e bashkëpunimit ndër-institucional dhe koordinimit ndërmjet autoriteteve, mund të jenë edhe organizatat joqeveritare vendore ose ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare që janë të specializuara në këtë fushë.

3. Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional përveç aspekteve të parandalimit të këtij fenomeni, duhet të përfshihen edhe aspektet që ndihmojnë fëmijët viktime në rehabilitimin e tyre fizik, psikologjik dhe emocional.

Neni 15 Roli dhe përgjegjësia e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe agjencive vartëse

1. Ministria e Punëve të Brendshme ka rolin qendror në koordinimin e veprimeve dhe aktiviteteteve në parandalimin, identifikimin, raportimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve të cilët marrin pjesë në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur apo forma tjera të ndaluara.

2. Ministria e Punëve të Brendshme përmes Akademisë së Kosovës për Siguri Publike do të përgatis programe të posaçme për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e mbrojtjes së fëmijës për ndalimin e pjesëmarrjes në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe forma të tjera të ndaluara.

3. Ministria e Punëve të Brendshme përmes Akademisë së Kosovës për Siguri Publike realizon përditësimin e kurrikulave trajnuese për specializimin e mëtutjeshëm të Zyrtarëve Policor në trajtimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.

4. Policia e Kosovës ndihmon autoritetet e tjera në parandalimin dhe luftimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe forma të tjera të ndaluara.

5. Policia e Kosovës përpilon plane të ndryshme veprimi me të cilat:

5.1. parandalon rreziqet që vijnë nga pjesëmarrja e fëmijëve në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe forma tjera të ndaluara;

5.2. identifikon fëmijët me rrezik potencial për të qenë viktime dhe atyre që mund të organizojnë kryerjen e veprimeve që bien ndesh me ndalesat e parapara me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe këtë Udhëzim Administrativ;

5.3. miraton PSO përmes së cilës përcaktohen në detaje parimet dhe standardet e veprimit nga ana e Policisë së Kosovës në lidhje me mbrojtjen e fëmijës sipas formave të ndaluara me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës dhe këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 16

Roli dhe përgjegjësia e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

1. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve me rastin e lëshimit të certifikatës së biznesit, si dhe komuna me lëshimin e lejes së punës për klubet e natës, qendrat e argëtimit për të rritur dhe format tjera të ndaluara për fëmijë sipas këtij Udhëzimi Administrativ, duhet të përcaktoj kushtet e operimit të tyre.

2. Bizneset e regjistruara si klube të natës mund të hapen dhe funksionojnë në një largësi prej së paku dy (2) kilometra në vijë ajrore nga ambientet shkollore dhe edukative.

3. Si pjesë e kushteve të licencimit dhe lejes së punës, bizneseve të regjistruara si klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe format tjera të ndaluara, duhet t'iu ndalohet edhe reklamimi afër shkollave dhe ambienteve edukative për aktivitetet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni.

4. Inspektorati i Tregut, në koordinimin dhe bashkëpunim me institucionet tjera të mandatuara për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ, harton plane për inspektimin e bizneseve.

5. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përditëson dhe përcakton rregulla të reja duke iu përshtatur ndalesave dhe kushteve të parapara me këtë Udhëzim Administrativ, me rastin e lëshimit të certifikatës së regjistrimit të bizneseve aktuale dhe ato të reja.

Neni 17

Roli dhe përgjegjësia e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka obligim të sigurojë zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve nga rreziqet e pjesëmarrjes në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe forma tjera të ndaluara, nëpërmjet parandalimit dhe reagimit përgjatë procesit të punës që zhvillohet në institucionet edukative, arsimore dhe aftësuese.

2. MASHTI akrediton programe që sigurojnë zbatimin e moduleve didaktike që ndihmojnë mësimdhënësit në trajtimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitete të ndaluara.
3. MASHTI bën ngritjen e kapaciteteve të stafit arsimor mbi sigurinë e fëmijëve dhe raportimin cilësor dhe referimin e rasteve.
4. MASHTI adreson këtë tematikë në të gjitha njësitë akademike universitare që përgatisin kuadro për të punuar me fëmijë.
5. MASHTI koordinon zbatimin e masave që dalin nga ky Udhëzim Administrativ më drejtoritë komunale për arsim.
6. MASHTI koordinohet me partnerët zhvillimor dhe shoqërinë civile në trajtimin sa më të mirë të mbrojtjes së fëmijës nga këto forma, nëpërmjet sistemit arsimor.

Neni 18

Roli dhe përgjegjësia e Qendrës për Punë Sociale

1. Qendrat për Punë Sociale ndërmarrin masa të nevojshme për identifikim, raportim dhe referim të rasteve të keqpërdorimit të fëmijëve të cilët kanë marrë pjesë në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe formave të tjera të ndaluara.
2. Qendrat për Punë Sociale ndërmarrin masa parandaluese dhe vetëdijësuese në shkolla, në lagje, dhe në komunitet, mbi rreziqet që shfaqen nga pjesëmarrja e fëmijëve në klube të natës dhe forma tjera të ndaluara.
3. Qendrat për Punë Sociale ofrojnë shërbime profesionale për mbrojtjen e fëmijëve që frekuenton klubet e natës, qendrat e argëtimit për të rritur apo format tjera të ndaluara.
4. Qendrat për Punë Sociale duhet të angazhojnë një zyrtar social për koordinimin e masave dhe ndërhyrjeve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e ndaluara sipas Ligjit përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës dhe këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 19

Roli dhe përgjegjësia e Inspektorateve përkatëse

1. Inspektorati i Tregut në bashkëpunim dhe koordinim me inspektoratet e tjera në nivel qendror dhe komunal, duhet të organizojnë inspektime dhe kontrole të rregullta dhe të jashtëzakonshme me qëllim zbatimin e ndalesave të parapara në Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës dhe këtë Udhëzim Administrativ.
2. Në rastet e shkeljes dhe kundërvajtjeve nga bizneset, Inspektorati ndërmerr veprimet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 20

Organizatat Joqeveritare

1. Organizatat Joqeveritare në kuadër të mandatit dhe përgjegjësi të tyre për mbrojtjen e fëmijëve nga pjesëmarrja në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur apo format tjera të ndaluara të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, angazhohen për:

1.1. përfaqësimin e zërit dhe interesave të të gjithë fëmijëve në strukturat vendimmarrëse;

1.2. përfaqësimin e pikëpamjeve të fëmijëve dhe promovimin e mbrojtjes së tyre nga pjesëmarrja në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe format tjera të ndaluara;

1.3. promovimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në të gjitha proceset që prekin interesat e tyre;

1.4. ndërmjetësimin dhe lehtësimin e komunikimit me autoritetet dhe institucionet përgjegjëse;

1.5. rritjen e vetëdijes për mbrojtjen e fëmijëve nga keqpërdorimet në klube të natës, dhe formave tjera të ndaluara;

1.6. avokimin për mbrojtjen e fëmijëve nga keqpërdorimet në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe formave tjera të ndaluara;

1.7. ofrimin e shërbimeve mbrojtëse për fëmijët të cilët janë viktimë apo atyre që janë në rrezik nga pjesëmarrja në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe forma tjera të ndaluara.

2. OJQ-të ndihmojnë dhe mbështesin autoritetet dhe institucionet përgjegjëse në zbatimin e obligimeve që dalin nga ky Udhëzim Administrativ, me theks të veçantë:

2.1. ngritjen e kapaciteteve;

2.2. vetëdijësimin;

2.3. bashkëpunimin vendor, regjional dhe ndërkombëtar.

Neni 21 **Ngritja e kapaciteteve**

1. Instituti i Kosovës për Administratë Publike, Akademia e Kosovës për Siguri Publike në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, Inspektoratet në nivel qendror dhe lokal, si dhe Policia e Kosovës, në kuadër të programeve ekzistuese apo përmes zhvillimit të programeve të reja, përgatisin kurrikula apo module të veçanta trajnuese për ngritjen e kapaciteteve profesionale të inspektorëve, zyrtarëve social, policëve, zyrtarëve publik dhe profesionistëve të tjerë në zbatim të këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjisllacionit përkatës që rregullon këtë fushë.

2. Programet trajnuese veçanërisht përmbajnë tema që ndërlidhen por nuk kufizohen vetëm në:

- 2.4.rolin dhe përgjegjësitë ligjore;
- 2.5.identifikimin dhe gjurmimin e rasteve;
- 2.6.raportimin;
- 2.7.referimin;
- 2.8.hetimin, dhe;
- 2.9.trajtimin.

3. Në zbatim të paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, institutet dhe akademitë trajnuese, mund të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet për realizimin e trajnimeve edhe me organizatat e shoqërisë civile.

Neni 22

Fushatat informuese

1. Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse së bashku me partnerët nga shoqëria civile dhe mediat punojnë me intensitet për të ndarë praktikatat dhe modelet pozitive në lidhje me mbrojtjen e fëmijës nga pjesëmarrja në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe forma tjera të ndaluara.
2. Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse zhvillojnë fushata informimi dhe ndërgjegjësimi, duke përfshirë fëmijët, prindërit, kujdestarët, komunitetin dhe të gjithë profesionistët për mbrojtjen e fëmijës.
3. Fushatat e informimit dhe ndërgjegjësimit duhet të fokusohen veçanërisht në:
 - 3.1.ngritjen e vetëdijes së fëmijëve mbi rrezikun e pjesëmarrjes së tyre në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur apo formave tjera të ndaluara;
 - 3.2.ngritjen e vetëdijes së prindërve mbi rrezikun e pjesëmarrjes së fëmijëve të tyre në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur apo formave tjera të ndaluara;
 - 3.3.ngritjen e vetëdijes mbi ndikimin afatgjatë në shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve;
 - 3.4.ngritjen e vetëdijes mbi ndikimin edukativ, familjar, ekonomik dhe social.
4. Fushatat e vetëdijesimit duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara në aspektin e dërgimit të mesazhit tek grupet e interesit dhe mobilizimin e tyre për kauzën e mbrojtjes së fëmijëve nga rreziqet e pjesëmarrjes në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe forma tjera të ndaluara.

Neni 23

Vetëdijesimi dhe fuqizimi i fëmijëve dhe prindërve

1. Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me Policinë dhe Ministrinë për Arsim, Shkencë, Teknologji dhe Inovacion dhe Drejtoritë Komunale për Arsim, ndërmarrin masa nëpërmjet të cilave synohet vetëdijesimi dhe fuqizimi i fëmijëve, prindërve dhe të gjithë qytetarëve në parandalimin dhe reagimin në lidhje me:

1.1. rrezikun e pjesëmarrjes së fëmijës në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur apo formave tjera të ndaluara;

1.2. të nxisë raportimin e faqeve *online* të cilat reklamojnë përmbajtjet e padëshiruara;

1.3. ngritjen e përgjegjësisë së përbashkët të institucioneve publike, organizatat e shoqërisë civile, mësuesve, prindërve, mediave për mbrojtjen e fëmijëve nga pjesëmarrja në klube të natës, qendra të argëtimit për të rritur dhe forma tjera të ndaluara.

2. Programet dhe masat për fuqizimin e fëmijëve dhe prindërve duhet të përqendrohen në tri drejtime:

2.1. Sjelljen dhe qasjen e fëmijëve dhe prindërve, ku këta arrijnë:

2.1.1. të njohin aftësitë dhe nevojat e tyre;

2.1.2. janë të aftë për të ndërmarrë veprime që ndikojnë në jetën e tyre;

2.1.3. janë të aftë të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e të drejtave të tyre;

2.1.4. ofrojnë njohuritë dhe përvojat e tyre për t'i ndihmuar të tjerët që janë të cenuar apo në nevojë për mbrojtje;

2.1.5. arrijnë vetëbesim të mjaftueshëm për tu përballur me kërcënimet ndaj tyre dhe të tjerëve;

2.1.6. kanë vullnet dhe dëshirë për tu marrë me sfidat apo problemet që i kanë goditur ata;

2.2. Aftësimin e fëmijëve dhe prindërve, ku këta arrijnë:

2.2.1. aftësimin për të vepruar;

2.2.2. janë të pajisur mjaftueshëm me njohuri, aftësi dhe informata;

2.2.3. kanë pavarësi për të menduar dhe vepruar si individ, por edhe në kuadër të grupeve apo organizimeve të ndryshme.

2.3. Krijimin e kushteve dhe mundësive për fëmijë dhe prindër, që janë:

2.3.1. fëmijët dhe prindërit dinë adresën e duhur për të kërkuar informatën dhe raportimin e shqetësimeve dhe brengave;

2.3.2. pajisjen me njohuri adekuate të fëmijëve dhe prindërve;

2.3.3. lehtësimin e formave të komunikimit ndërmjet institucioneve në njëri-anë, dhe fëmijëve dhe prindërve në anën tjetër;

2.3.4. edukimin e ndërsjellë për të rritur besimin dhe ndërveprimin ndërmjet prindërve dhe fëmijëve.

Neni 24

Nxjerra e listës së produkteve të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë e fëmijës

1. Jo më larg se 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, dhe Tregtisë duhet të freskojë listën e produkteve të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë e fëmijës.

2. Menjëherë pas nxjerrjes së listës sipas paragrafit 1. të këtij neni, MINT duhet të publikojë këtë listë në portalin shtetëror, ueb faqen e ministrisë, si dhe përmes mjeteve të tjera të përshtatshme të informimit. Ministria, gjithashtu i njofton bizneset për obligimin e zbatimit të listës.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

25/08/2023